



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.431/6 prot.

Tiranë, më 21.3.2023

REKOMANDIM

Nr. 17, datë 21.3.2023

PËR KONTROLLUESIN “BANKA KOMBËTARE TREGTARE” SHA

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Banka Kombëtare Tregtare” SHA (në vijim, “Kontrolluesi),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 33, datë 22.02.2023 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasi I. B., në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi “Banka Kombëtare Tregtare” SHA, ka në objekt të veprimtarisë së saj shërbimin dhe këshillimin financiar e bankar.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë “punëmarrës”, “klientë”, etj.

2. Në kuadër të verifikimit të ankesës të paraqitur nga z. I. B., nëpërmjet së cilës pretendon se Banka Kombëtare Tregtare i ka përhapur pa dijenin e tij, ish-

punëdhënësit (kompanisë “*Extrabis SHPK*”), të dhënat si IBAN-in dhe numrin e llogarisë personale rezultoj se, përfaqësuesja e kompanisë “*Extrabis SHPK*”, e cila dispononte dokumentin e pagesës së kryer të datës 19.09.2022, në llogarinë e ankuesit, numrin e referencës së veprimit dhe IBAN-in e tij, është paraqitur pranë degës Kashar, për verifikimin e një pagese të kryer, nga llogaria e kompanisë drejt llogarisë së ankuesit.

Nga verifikimi i kryer rezulton se, Kontrolluesi i ka vendosur në dispozicion përfaqësueses së kompanisë, dokumentin i cili konfirmon llogarinë bankare të ankuesit, ku në përmbajtje të saj përfshihet edhe IBAN-i, në kundërshtim me kriteret ligjore të përpunimit të parashikuara në nenin 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përhapja e të dhënave, si formë e posaçme përpunimi (*sipas përkufizimit në pikën 12, të nenit 3 të Ligjit*), duhet të realizohet në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Referuar pikës 20, të nenit 3 të Ligjit, përhapja e të dhënave nënkupton komunikimin e informacionit për të dhënat personale palëve të papërcaktuara, në çfarëdo forme, edhe përmes vënies në dispozicion ose për konsultime.

Përhapja e të dhënave e subjekteve të të dhënave (në rastin konkret të ankuesit), konsiderohet përpunim dhe përpunimi i të dhënave legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit. Të dhënat personale përpunohen vetëm: *a) nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin;... ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;...*

Në këtë rast, kërkesa për konfirmimin e të dhënave të ankuesit duhet të bazohet në një parashikim ligjor konkret me qëllim që përhapja të konsiderohet e ligjshme.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare nëpërmjet shkresës nr. 431/4 prot., datë 09.03.2023.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancë dëgjimore, të zhvilluar në datën 16.03.2023, dhe u shpreh se Kontrolluesi vetëm ka konfirmuar IBAN-in dhe nr. e llogarisë së ankuesit, informacion që kompania “*Extrabis SHPK*” e dispononte më herët.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuadër të garantimit të të drejtave për subjektet e të dhënave dhe garantimit të ligjshmërisë së përpunimit. Hartimi i rregullave specifike nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton

përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të hartoj rregulla specifike për të garantuar përpunimin/përhapjen e ligjshme të të dhënave personale, në raste të ngjashme;
2. Kontrolluesi, të këtë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 6 të Ligjit;
3. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikën 1 më sipër;
 - (ii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 2 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

4. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
5. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 21.03.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi